



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 758/prot.
1

Tiranë më 8.1.2020

Lënda: Mendim mbi një projektligj

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 11469 Prot., datë 18.06.2020, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, në vijim gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Me qëllim garantimin e masave për sigurinë e të dhënave personale që do të përpunohen në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, sugjerojmë që pas pikës 5, të nenit 4, të projektligjit të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: “Regjistri i Pronarëve Përfitues, ndërtohet në mënyrë të tillë që të garantohen masat për sigurinë e të dhënave, parimi i mjaftueshmërisë dhe proporcionalitetit, lidhur me përpunimin e të dhënave, në respektim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Gjithashtu, në respektim të nenit 18 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, (në vijim “ligji për mbrojtjen e të dhënave personale”), sugjerojmë që pas pikës 6, të nenit 7, të projektligjit të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: “Pronarët përfitues, në cilësinë e subjekteve të të dhënave personale, informohen për subjektet që aksesojnë të dhënat e tyre, sipas parashikimit të pikës 5 të këtij neni.”

Më tej, në funksion të garantimit të parimeve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, sugjerojmë që pas pikës 8, të nenit 7, të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: “Çdo veprim në regjistër lidhur me aksesin, ndryshimet, korrigjimet, përhapjen e të dhënave, etj, duhet të lërë gjurmë me qëllim garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave”.

Së fundmi, vërejmë se në pikën 5.2.1, të nenit 4 të projektligjit, janë përcaktuar të dhënat e detyrueshme për pronarët përfitues të subjektit raportues që duhet të përmbajë Regjistri i Pronarëve Përfitues. Nga të dhënat e identifikimit, ndër të tjera është edhe “Datëlindja”.

Rrjedhimisht, nga pikëpamja e teknikës legislative, do të sugjerohet zëvendësimin e germës c) të pikës 1, të nenit 7 të projektligjit nga: “viti dhe muaji i lindjes” në “Datëlindja” me qëllim unifikimin e terminologjisë.

Me përfshirjen e sugjerimeve të mësipërme, projektligji vlerësohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

